



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.212/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.05.2021 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Get Klin” ShPK, në procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime”, Nr. REF-90904-03-24-2021 me objekt “*Blerje materiale pastrimi dhe detergjent*” Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 12 muaj”, me fond limit 3,305,234 (tre milion e treqind e pesë mijë e dyqind e tridhjetë e katër) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 06.04.2021 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Shkodër.

Ankimues: “Get Klin” ShPK

Adresa: Durrës Lagjja 14, Rruga Vesa, Zona Industriale Shkozë, Godinë me Nr. Pasurie 6/357, Kati I-rë

Autoriteti Kontraktor: Spitali Rajonal Shkodër

Adresa: Rruga “Kolë Heqimi” 11, Shkodër

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”,*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:**I***Vlerësimi paraprak*

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 25.03.2021 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozime”, Nr. REF-90904-03-24-2021 me objekt “*Blerje materiale pastrimi dhe detergjent*” Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 12 muaj”, me fond limit 3,305,234 (tre milion e treqind e pesë mijë e dyqind e tridhjetë e katër) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 06.04.2021 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Shkodër.

II.2. Në datën 06.04.2021 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 15.04.2021 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Get Klin	2,185,300.00	I skualifikuar
- Ervin Luzi	2,350,200.00	I skualifikuar
- Euro Mega 2010	2,547,900.00	I skualifikuar
- Atlantik 3	3,108,500.00	I skualifikuar
- Sofia Myftari	3,185,400.00	I skualifikuar
- Mifeel	3,285,400.00	I skualifikuar
- Murati D	pa ofertë	
- Dimex	pa ofertë	
- Best-T Capital Invest	pa ofertë	

II.4. Në datën 15.04.2021 operatori ekonomik “Get Klin” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsytet si më poshtë vijon:

-Mostrat e mëposhtme nuk janë sipas specifikimeve teknike të DST-ve:

- *Qese plastmasi janë me përmasa 75*100cm me peshë 12L;*
- *Shtupa e pambukut nuk është mikrofibër që thith ujin shumë mirë”.*

II.5. Në datën 16.04.2021, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e mësipërme të prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë:

[...] I nderuar autoritet kontraktor, sot jemi njohur me refuzimin nga ana juaj e ofertës të dhënë nga “Get Klin” SHPK. Arsyeja e refuzimit nga ana juaj është se:

- *Qese plasmasi janë me përmasat 75*100 cm me peshë 12L.*

Në bazë të specifikimeve teknike të paraqitura në shtojcën nr.9 nga ju për qeset e plasmasit thuhet se: 18. Qese plastmasi me përmasa te ndryshme për spitale, Qeset

do të përdoren për mbeturinat dhe teshat e palara. Të jenë rezistente, me kapacitet jo më pak se 15 kg, me përmasa min 90x60cm. Të jenë të paketuara në formë ruloje në numra të ndryshme fijesh. Të jetë produkt i biodegradueshëm.

Artikulli nr.7 qese plastike përbën vetëm 5% të ofertës ekonomike. Në mostrën e dorëzuar nga ana e “Get Klin” ShPK pranë autoritetit kontraktor, dimensionet janë si më poshtë 75*100cm dhe jo 12L siç thuhet në refuzimin e ofertës, por është 120L, shikoni mirë etiketën e mostrës. Pra, sipërfaqja e qeses tonë është $75*100=7500\text{cm}^2$. Sipërfaqja e qeses tuaj është $90*60=5400\text{cm}^2$. Pra, mostra e dorëzuar nga “Get Klin” ShPK është 2100cm^2 më e madhe dhe i përmbush dhe i tejkalon. Në specifikimet tuaja me qesja duhet me përmasa të ndryshme dhe nuk është e specifikuar qartë se çfarë përmase kërkon AK por minimumi i qeses të jetë 90*60cm, 15kg, që do të thotë se mostra që kemi dorëzuar pranë jush është më e madhe se përmasa që ju keni kërkuar. Ajo që është për tu theksuar është fakti që ky artikull është vetëm 5% i ofertës ekonomike.

- Shtupat e pambukut nuk janë mikrofibër që thithin ujin shumë mirë. Sipas DST ju kërkon: 19. **Shtupë pambuku për larje dysHEMEJE me veshje Plastike** përbërë nga fibra tekstili pambuku dhe mikrofibër që thithin ujin shumë mirë. T’i bashkëngjitet shtupës, shkopi me veshje plastike me gjatësi normale, jo më të shkurtër se 100 cm, të jetë me efekt vidhimi. Materiali i shkopit të jetë alumini nga brenda dhe plastik nga jashtë.

Artikulli nr.3 shtupa pambuku përbën vetëm 3% të ofertës ekonomike. Mostra që ka dorëzuar “Get Klin” ShPK është mostër shtupë pambuku (siç është e shkruar në preventiv), me fibra tekstili që thithin ujin shumë mirë pasi specifikimi juaj ka qenë i paqartë dhe nuk e ka përcaktuar që shtupat të jenë ose pambuku ose mikrofibër, pasi në treg nuk rezulton një shtupë e cila të jetë dhe pambuk dhe mikrofibër. Në çfarë laborator jeni drejtuar ju si komision për analizën e shtupës për thithjen e ujit që keni dalë në përfundimin për mosthithje të mirë të ujit, pasi ka labore të specializuara dhe të certifikuara që merren me analiza të këtyre kërkesave ndaj produktit. Ajo që është për tu theksuar është fakti që ky artikull është vetëm 3% i ofertës ekonomike.

I nderuar AK, oferta e dorëzuar nga “Get Klin” ShPK që përmbush të gjitha kriteret e kërkuara nga AK Sr Shkodër është me vlerë 2,185,300 lekë ndërsa fondi juaj limit është në vlerën 3,305,234 lekë, që do të thotë diferenca nga oferta jonë me fondin limit është shumë e madhe. “Get Klin” ShPK, e cila përmbush dhe është e gatshme për realizimin e kësaj procedure i kursen AK një shumë të madhe. Për çdo AK, kjo diferencë shume, do të ishte e vlefshme për të kursyer dhe për të ndihmuar buxhetin e AK. Shpresojmë që kërkesa jonë të merret parasysh duke na shpallur fitues si oferta ekonomike më e mirë. Duke shpresuar për një gjykim të drejtë presim përgjigje nga ju pasi ne nuk do ndalemi duke kërkuar të drejtën në APP dhe nëpër institucionet e duhura [...].

II.6. Në datën 23.04.2021 me shresën nr.924/3 prot operatori ekonomik ankimues ka marrë dijeni lidhur me mospranimin e ankesës nga autoriteti kontraktor me argumentet si më poshtë: “Në lidhje me pikën 4 në seksionin 2.3 Për kapacitetin teknik: Operatori ekonomik duhet që mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara në DST.

1. **Shtupë pambuku për larje dysHEMEJE me veshje Plastike** përbërë nga fibra tekstili pambuku dhe mikrofibër që thithin ujin shumë mirë. T'i bashkëngjitet shtupës, shkopi me veshje plastike me gjatësi normale, jo më të shkurtër se 100 cm, të jetë me efekt vidhimi. Materiali i shkopit të jetë alumini nga brenda dhe plastik nga jashtë.

2. **Qese plastmasi me përmasa te ndryshme për spitale**, Qeset do të përdoren për mbeturinat dhe teshat e palara. Të jenë rezistente, me kapacitet jo më pak se 15 kg me përmasa min 90x60cm. Të jenë të paketuara në formë ruloje ne numër te ndryshme fijesh. Të jetë produkt i biodegradueshëm.

Nga verifikimi i mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik me shkresën nr.839 prot 06.04.2021 pranë Spitalit Rajonal Shkodër rezulton se:

1.Qese plastmasi janë me përmasa 75*100cm, me paketim 10copë/120litra më e vogël se përmasat e kërkuara nga institucioni jonë 90*60cm e peshë jo më pak se 15kg/copa.

2.Shtupa e pambukut nuk është mikrofibër që thith ujin shumë mirë.

Kemi arritur në këtë vendim duke parë produktet e sjella nga ana juaj të cilat kanë etiketa me specifikimet përkatëse. Komisioni argumenton bazuar në ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 me ndryshimet përkatëse, nenit 1 pika 2, i cili parashikon shprehimisht se: Qëllimi i këtij ligji është:

a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Duke qenë se për autoritetin kontraktor është e nevojshme edhe e mjaftueshme që operatorët ekonomikë të plotësojnë të gjitha kapacitetet ekonomike, teknike, profesionale për realizimin me sukses të kontratës duke evituar kushte kufizuese, bazuar dhe në nenin 62 të LPP “Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës”, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetë cilësimin e tij ligjor, si autoritet me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. Për sa theksuam më sipër, komisioni arsyeton se pretendimi i operatorit ekonomik për pikën 4 në seksionin 2.3 Kapaciteti teknik nuk qëndron”.

II.7. Në datën 28.04.2021 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr.1048/4 prot datë 06.05.2021, protokolluar me tonën me nr.714/3 prot datë 10.05.2021 me objekt “Dërgohet informacioni”, është depozituar në Komisionin e

Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Get Klin” ShPK mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij, me arsyetimin se “[...]I nderuar autoritet kontraktor, sot jemi njohur me refuzimin nga ana juaj e ofertës të dhënë nga “Get Klin” ShPK. Arsyeja e refuzimit nga ana juaj është se:

- Qese plastmasi janë me përmasat 75*100 cm me peshë 12L.

Në bazë të specifikimeve teknike të paraqitura në shtojcën nr.9 nga ju për qeset e plastmasit thuhet se: 18. **Qese plastmasi me përmasa te ndryshme për spitale**, Qeset do të përdoren për mbeturinat dhe teshat e palara. Të jenë rezistente, me kapacitet jo më pak se 15 kg, me përmasa min 90x60cm. Të jenë të paketuara në formë ruloje ne numër te ndryshme fijesh. Të jetë produkt i biodegradueshëm.

Artikulli nr.7 qese plastike përbën vetëm 5% të ofertës ekonomike. Në mostrën e dorëzuar nga ana e “Get Klin” ShPK pranë autoritetit kontraktor, dimensionet janë si më poshtë 75*100cm dhe jo 12L siç thuhet në refuzimin e ofertës por është 120L, shikoni mirë etiketën e mostrës. Pra, sipërfaqja e qeses tonë është $75*100=7500\text{cm}^2$. Sipërfaqja e qeses tuaj është $90*60=5400\text{cm}^2$. Pra, mostra e dorëzuar nga “Get Klin” ShPK është 2100cm^2 më e madhe dhe i përmbush dhe i tejkalon. Në specifikimet tuaja me qesja duhet me përmasa të ndryshme dhe nuk është e specifikuar qartë se çfarë përmase kërkon AK, por minimumi i qeses të jetë 90*60cm, 15kg që do të thotë se mostra që kemi dorëzuar pranë jush është më e madhe se përmasa që ju keni kërkuar. Ajo që është për tu theksuar është fakti që ky artikull është vetëm 5% i ofertës ekonomike.

- Shtupat e pambukut nuk janë mikrofibër që thithin ujin shumë mirë. Sipas DST ju kërkon: 19. **Shtupë pambuku për larje dyshemeje me veshje Plastike** përbërë nga fibra tekstili pambuku dhe mikrofibër që thithin ujin shumë mirë. T’i bashkëngjitet shtupës, shkopi me veshje plastike me gjatësi normale, jo më të shkurtër se 100 cm, të jetë me efekt vidhimi. Materiali i shkopit të jetë alumini nga brenda dhe plastik nga jashtë.

Artikulli nr.3 shtupa pambuku përbën vetëm 3% të ofertës ekonomike. Mostra që ka dorëzuar “Get Klin” ShPK është mostër shtupë pambuku (siç është e shkruar në preventiv), me fibra tekstili që thithin ujin shumë mirë pasi specifikimi juaj ka qënë i paqartë dhe nuk e ka përcaktuar që shtupat të jenë ose pambuku ose mikrofibër pasi në treg nuk rezulton një shtupë e cila të jetë dhe pambuk dhe mikrofibër. Në çfarë laborator jeni drejtuar ju si

komision për analizën e shtupës për thithjen e ujit që keni dalë në përfundimin për mosthithje mirë të ujit, pasi ka laboratore të specializuara dhe të certifikuara që merren me analiza të këtyre kërkesave ndaj produktit. Ajo që është për tu theksuar është fakti që ky artikull është vetëm 3% i ofertës ekonomike.

I nderuar AK, oferta e dorëzuar nga “Get Klin” ShPK që përmbush të gjitha kriteret e kërkuara nga AK Sr Shkodër është me vlerë 2,185,300 lekë ndërsa fondi juaj limit është në vlerën 3,305,234 lekë, që do të thotë diferenca nga oferta jonë me fondin limit është shumë e madhe. “Get Klin” ShPK, e cila përmbush dhe është e gatshme për realizimin e kësaj procedure, i kursen AK një shumë të madhe. Për çdo AK, kjo diferencë shume, do të ishte e vlefshme për të kursyer dhe për të ndihmuar buxhetin e AK. Shpresojmë që kërkesa jonë të merret parasysh duke na shpallur fitues si oferta ekonomike më e mirë. Duke shpresuar për një gjykim të drejtë presim përgjigje nga ju pasi ne nuk do ndalemi duke kërkuar të drejtën në APP dhe nëpër institucionet e duhura [...], Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.4 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

”4.OE duhet të paraqesin:

- Mostrat në datën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë Spitalit Rajonal Shkodër.
- Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë elementët: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e Operatorit Ekonomik.
- Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara”.

III.1.2. Në shtojcën 9 “Specifikimet teknike” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Shtojca 9

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Specifikimet teknike:

1. **Solucion larës dysHEMEJE(pllakash):** me veti të mira pastruese dhe aromatizuese. Ambalazhimi në shishe plastike 1 ose >1 Liter. Gjendja fizike: të jetë solucion lëng, me aromë parfumi. Vlera e PH 5 deri në 10. Paraqitja fizike e solucionit të jetë homogjen. Tretshmëria në ujë të jetë 100%. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³ - 1.1 gr/cm³. Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë jo më shumë se 10%. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
2. **Solucion larës xhamash,** me efekt pastrimi dhe shkëlqim të xhamave. Ambalazhimi në shishe plastike me mekanizëm sprucimi 750 ose >750 ml . Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Gjendja fizike e lëngut të jetë homogjen, të ketë aromë parfumi. Vlera e PH 5 deri në 11. Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Solucioni të jetë homogjen dhe të ketë densitet 0.9 gr/cm³ deri në 1.2 gr/cm³. Lënda tensioaktive të variojë nga 1.0 % deri në 4.0 %.
3. **Shtupë pambuku për larje dysHEMEJE me veshje Plastike** përbërë nga fibra tekstili pambuku dhe mikrofibrë që thithin ujin shumë mirë t'i bashkëngjitet shtupës, shkopi me veshje plastike me gjatësi normale, jo më të shkurtër se 100 cm, të jetë me efekt vidhimi. Materiali i shkopit të jetë alumini nga brenda dhe plastik nga jashtë.
4. **Acid për pastrim,** të jetë solucion efikas në heqjen e kripërave të depozituara si dhe papastërtive. Ambalazhimi në shishe plastike 1 ose >1Liter Të përmbaje në masën 12% deri në 30% acid klorhidrik. Vlera e pH 0 - 3. Densiteti i acidit të jetë 1.0 deri 1.5 gr/cm³. Të jetë i tretshëm në ujë 100 %.Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
5. **Fshesë pastrimi pa bisht.** Fshesa të jetë me fije të dendura, të buta plastike, me gjatësi mbi 10 cm. Të jetë për pastrim të ambienteve të brendshme. Të jenë rezistente gjatë forcës së fshirjes së sipërfaqes. Koka të jetë e montueshme dhe e çmontueshme me mekanizmin e rrotullimit nga e djathta në montim me shkopin. Vendi i vendosjes së shkopit të jetë standard. Pesha e saj të jetë jo më e vogël se 340 gr.
6. **Klori (pluhur)** është një mjet i forte baktericid, me veti të forta oksiduese. Përdoret për dizefektimin e lëndëve të ndryshme, hapësirave dhe sipërfaqe të ndryshme dhe ujë.
7. **Qese plastmasi me përmasa të ndryshme për spitale,** Qeset do të përdoren për mbeturinat dhe teshat e palara. Të jenë rezistente, me kapacitet jo më pak se 15 kg me përmasa min 90x60cm. Të jenë të paketuara në formë ruloje ne numër te ndryshme fijesh. Të jetë produkt i biodegradueshëm.
8. **Doreza gome** të jenë rezistente të mira ndaj kimikateve të detergjentëve dhe kimikatëve të pastrimit. Të jenë për përdorim të larjes së murit e pllakave. Të jenë të qëndrueshme dhe të përshtatshme në përdorim dhe të padeportueshme nga lëngjet. Masa te jenë sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.
9. **Sapuntualetiduarsh:** Të jetë cilësor, me aftësi shkumuese të lartë. Ambalazhimi nga fabrika të jetë 100 os e>100gr Paraqitja fizike të jetë e ngurtë, paketimi të ketë të evidentuar markën dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Vlera e pH të jetë 7 deri në 10. Densiteti të jetë nga 0. 9 derinë 1.2 gr/cm³. Tretshmëria në ujë të jetë jo më e vogël se 95 %. Lartësia e shkumës të jetë më e vogël se 5 cm.
10. **Solucion larës enësh xhel,** me efekt pastrimi të thellë të yndyrnave. Ambalazhimi në enë plastike me kapak 250 ose >250 ml. Te ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e

prodhimit të fabrikës. Gjendja fizike e produktit të jetë xhel (në formë paste). Tretshmëria në ujë të jetë 100%. Vlera e PH 6.5 deri në 8. Densiteti të variojë nga 0.9 gr/cm³ deri në 1.2 gr/cm³. Lënda tensioaktive të jetë nga 20% deri në më 35%.

11. **Pluhur larës për lavatriçe, për rroba të bardha:** të ketë aftësi vepruese dhe pastruese të larta. Pamja e jashtme: masë e pluhurizuar , e granuluar. Densiteti të jetë nga 0.6 gr/cm³ deri në 1.1 gr/cm³. Vlera e pH të jetë 9 deri në 11. Tretshmëria në ujë më e madhe ose e barabartë me 95 %. Të përmbajë lagështi jo më shumë se 10%. Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë 5% deri 15 % dhe ≤5% për lëndët tensioaktive kationike dhe anionike). Përmbajtja e perboratit të jetë jo më pak se 2 %. Aftësia shkumuese të jetë me e vogël se 5 cm. Ambalazhimi në qese plastike/kuti kartoni 1 ose >1 Kg. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
12. **Shkopa inoksi:** jo më të shkurtër se 120 cm. Materiali i shkopit të jetë alumini me veshje plastike. Të ketë mekanizëm montues (efekt vidhimi) dhe shumë rezistent.
13. **Sfungjer për pastrim hidrosanitairesh,** një paketim të ndryshëm. Të jetë me pore të vogla në përbërjen e sfungjerit dhe me rrjete teli të butë për pastrim sipërfaqesh të ashpra. Anësoret të jenë me kanal për mbrojtjen e duarve.
14. **Kosha** plastik për hedhjen e mbeturinave me kapacitet mbi 10 L.
15. **Kovë plastike me shtrydhje,** të jetë plastike, me kapacitet sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor, e thellë dhe të kenë një dorezë mbajtëse nga sipër për transportimin e kovës, kova të jetë së bashku me kapakun e shtrydhjes së shtupës sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor. Kapaciteti mbajtës të jete me volum min 10 Liter.
16. **Solucion kundra yndyrës:** të ketë veti të mira pastruese në të gjitha sipërfaqet, të jetë në shishe plastike me mekanizëm sprucimi. Gjendja fizike e lëngut të jetë solucion homogjen, të ketë aromë parfumi. Vlera e pH të jetë 10 deri në 14. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³ deri në 1.3 gr/cm³. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Ambalazhimi në shishe plastike 750 ose >750 ml.
17. **Brisqe rroje** të jenë të përbëra nga një ose më shume tehe të briskut. Te jene cilësor dhe njëpërdorimsh.

-Skadencën e detergjentëve duhet të jetë jo më pak se 1 (një) vit nga momenti i levrimin të mallit.

- Flete-Analizë ose dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare ,të lëshuara nga Institucione të autorizuar, që vërtetojnë përputhshmërinë e produkteve me specifikimet teknike (Detergjente + Solucion pastrimi) ”.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha

kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit”.

III.1.4. Në nenin 23, pika 4, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet se: *“4. Përshkrimi i punimeve, mallrave apo shërbimeve duhet të përmbajë specifikimet teknike, që duhet të plotësohen në rast nevojë, edhe plane, vizatime, modele, makete etj. Në rast të përshkrimit funksional të punimeve apo të mallit, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës. Nga përshkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale. Që të garantohet krahasueshmëria e ofertave për kërkesat e objektit të kontratës, për këto punime ose për funksionin e tyre, kërkesat e rendimentit dhe të funksionit duhet të jenë të sakta për t’u dhënë konkurruesve dhe ofertuesve një ide të qartë në përgatitjen e ofertës. Në përshkrimin e punimeve duhet të shënohen, kur është rasti, edhe specifikimet për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve, të përshtatshme për mjedisin”.*

III.1.5. Në nenin 27 pika 6 gërma “a” të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a)mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit dhe/ose b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike”.*

III.1.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.7. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose

kandidatëve, parashikuar nga neni 2 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës barazisë, dhe mosdiskriminimit janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.1.8. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të procedurës së ankimuar, të administruar pranë KPP, si dhe bazuar në pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, konstatohet se në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit objekt ankimi rezulton se, për artikullin e shtupës së pambukut për larje dysHEMEJE me veshje plastike, konstatohet se, në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit objekt ankimi rezulton se, për këtë artikull, kërkohet të jetë e përbërë nga fibra tekstili pambuku dhe mikrofibër që thithin ujin shumë mirë. Ndërkohë, mostra e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, për artikullin shtupë, mbi ambalazimin e tij, konkretisht cilësohet se, përbërja është pambuku, prodhohet nga një ndërlidhje fibrash të holla pambuku. Komisioni gjykon se, mostra e artikullit shtupë, paraqitur për këtë procedurë prokurimi, nuk e përmbush kriterin e kualifikimit dhe nuk është në përputhje me specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, pasi autoriteti kontraktor ka kërkuar në specifikimet teknike shtojca nr.9, që shtupa të jetë e përbërë nga fibra tekstili pambuku dhe mikrofibër. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, autoriteti kontraktor, me të drejtë ka skualifikuar operatorin ekonomik ankimues pasi mostra e paraqitur prej tij nuk është në përputhje me specifikimet teknike të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Konkretisht, mostra lidhur me shtupën është në përbërje të ndryshme nga ajo e kërkuar në specifikime teknike të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, pasi nuk përmbush specifikimin teknik të përbërjes së saj përfshirë dhe materialin mikrofibër.

Komisioni thekson se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Në rastin konkret, Komisioni referuar mostrës së paraqitur (shtupë) nga operatori ekonomik ankimues në datën e hapjes për këtë procedurë prokurimi, gjykon se nuk mund të konsiderohen se është në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

III.1.9. Gjithashtu, Komisioni sqaron se nëse operatori ekonomik do të kishte pretendime në lidhje me kriteret/specifikimet teknike të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit*

Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”.

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementesh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatorët ekonomikë do të kishin paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, kanë patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “ [...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Get Klin” ShPK nuk qëndron.

III.1.10. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Get Klin” ShPK ndaj vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. do të jetë e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik, e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Get Klin” ShPK për procedurën e prokurimit, “Kërkesë për Propozime”, Nr. REF-90904-03-24-2021 me objekt “*Blerje materiale pastrimi dhe detergjent*” Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 12 muaj”, me fond limit 3,305,234 (tre milion e treqind e pesë mijë e dyqind e tridhjetë e katër) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 06.04.2021 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Shkodër.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedures së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 714 Protokolli, Datë 28.04.2021.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Vilma Zhupaj

Anëtar

Lindita Skeja

Anëtar

Merita Zeqaj

Kryetar

Jonaïd Myzyri